

LETRAT E LEXUESVE:

I dashuri Shefki, tungjatjeta!

Dëshiroj që letra ime të gjej shëndosh e mirë...

...Atë natë që e kanë burgosur Sokol Dobrunën e Mentor Kaçin "agallarët e Udbës" më kishin kërkuar edhe mua... Pas njëqind mundimeve memzi që iu shpëtova nga kthetrat!... Posa arrita në Gjermani vendosëm me disa shokë t'i shthurim klubet jugosllave, për të cilën gjë u desht një punë e madhe, sepse fatkeqësisht ka ende edhe asish që kurrë s'i ndërprejnë ec-e-jaket me ambasaden jugosllave... Ç'është për t'u habitur, ata janë futur edhe në LDK dhe kanë zënë shpesh kryet e vendit. Po është e pafalshme që disa, duke e vënë në shënjestër komunizmin dhe enverizmin, ata po e vrasin Shqipërinë dhe përpjekjet tona për afrim e bashkim kombëtar... Unë jam në luftë të pandërprerë me këso llapangjozësh, e deri më tani i kam mbajtur më se 64 ligjërata e kumtesa shkencore për bashkatdhetarët tanë e miq gjermanë...
...Më gërryen pa masë dashuria e malli për Kosovën. Mendoja se pas një viti do shihja sërish Kosovën! Ja, tani po mbushet pesëviti që unë ende rrugëve të botës! Zembrën ma brejnë vargjet e Filip Shirokës:

M'qaj bilbil kur drita e hanës

Bie mbi vorre m'i zbardhu

M'qaj bilbil o mbret i kangës

Se n'dhe t'huej kanë me m'vorru...

Të fala vëllazrore: Shefqet Canhasi, Gjermani

PS. Po t'i dërgoj disa materiale, të cilat mund t'i botosh në gazetën DRITA

Z. Shefki!

Edhe pse nuk njihemi, personalisht, në saje të revistës "Drita" mund të them se iu njoh. Unë kaq-veç fjalë miradie për gazetën tuaj. I përshëndes bashkëpunëtorët tuaj z. Hajdin Abazin e Zeqir Ramën... Me pëlqejnë shumë DOKUMENTET, ku çdo gjë që është thënë-është e vërtetuar...

Përshëndetje të sinqerta nga:

Ismet Berisha

Oskar gt. 10

1706 Sarpsborg

Norvegji

I nderuari redaktor!

Ju falemnderit shumë që më dërguat disa numra të "Dritës" Gradualisht "Drita"

po merr fizionominë e një reviste serioze, dhe po përsoset në përkrahjen cilësore.

Kam dëshirë të bashkëpunoj me këtë revistë në të ardhmen.

Mezë më kërkuat diçka, po ua dërgoj disa poezi të shkruana në çaste të ndryshme frymëzimi.

Me nderime: Qerim Rexhepi

Revistë kulturore - informative Shoqata Besa, në Trelleborg-Suedi
Kultur-och informationstidskrift Föreningen Besa i Trelleborg-Sverige

DRITA

Viti I
Nr. 8/96
Çmimi
30 :-

KADARE, URIME SHPALLJA E ANËTARIT TË AKADEMISË FRANCEZE
TË SHKENCAVE MORALE DHE POLITIKE!



ALBANSKA FÖRFATTAREN ISMAIL KADARE, VALDES IN SOM
LEDAMOT I DEN FRANSKA AKADEMIEN